

РЕЗИМЕ ЗА ПРОЕКТОТ

Emri i projektit	“Përforcim i kapaciteteve të bashkësive lokale për ballafaqim me dezinformatat dhe dezinformatat me bazë gjinore”
E mbështetur nga	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP)
Programi	Projekti është pjesë e Kornizës Programore për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP)
Roli i SHGM	Bashkëpunëtor i projektit
Buxheti total	3,904,050 denarë
Granti nga donatori:	3,904,050 denarë
Periudha e realizimit	Tetor 2023 – Maj 2024
Territori	Maqedonia e Veriut
Për projektin	Përmbledhje
Konteksti	Duke filluar nga viti 2023, Zyra e UNDP-së në Maqedoninë e Veriut po fillon një projekt që synon forcimin e kapaciteteve të komuniteteve lokale për t'u marrë në mënyrë efektive me dezinformimin dhe dezinformimin e bazuar në gjini. Projekti i titulluar “Përforcim i kapaciteteve të bashkësive lokale për ballafaqim me dezinformatat dhe dezinformatat me bazë gjinore” synon të kontribuojë në rritjen e ndërgjegjësimit dhe forcimin e kapaciteteve të komuniteteve lokale për të qenë më rezistente ndaj informacionit të rremë dhe të pasaktë. Kjo përmes produkteve të besueshme gazetareske për të ekspozuar dezinformatat dhe narrativat në lidhje me çështjet lokale nga disa qytete më të vogla në vend, si dhe nëpërmjet rritjes së ndërgjegjësimit shoqëror për dezinformimin me bazë gjinore.
Qëllimi	Krijimi i një platforme dixhitale dhe krijimi i produkteve të besueshme gazetareske për ekspozimin e dezinformatave dhe narrativave që vendosen për çështje lokale nga disa qytete më të vogla të vendit, të cilat duhet të kontribuojnë në ndërgjegjësimin dhe forcimin e kapaciteteve të komuniteteve lokale për të qenë më rezistente ndaj lajmeve të rrejshme dhe të pa sakta, si dhe rritje të ndërgjegjësimit social për dezinformimin me bazë gjinore. Gjithashtu, qëllimi është stimulimi dhe promovimi i gazetarisë etike përmes dhënies së çmimeve gazetareske.
Grupe caku	Gazetarë, opinionimi më i gjerë
Rezultate të pritshme	- Platformë web e zhvilluar dhe operative - Produkte të krijuara gazetareske me fokus efektet negative nga dezinformatat dhe dezinformatat e bazuara gjinore që kanë rëndësi për bashkësitë lokale nga qytetet më të vogla të RMV-së - Interaksion më i mirë në relacion gazetarë – shoqata civile, për kontribut në tema me rëndësi lokale
Aktivitete bartëse	Aktivitetet kyçe të projektit janë: - Zhvillimi i platformës dixhitale - Krijimi i përmbajtjes së re gazetareske dhe mbështetje për rregullimin e produkteve finale - Çmime për qasje kreative dhe ngjarje promovuese - Kontribut për krijimin dhe mbështetje për promovimin e udhëzimit për integritet mediatik

Logo (e donatorit)	  Supporto al decente in Macedonia
--------------------	--